



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 234, datë 18.05.2023

**PËR NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 145, DATË 28.03.2023,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR CAKTIM GJYQTARI, NË
NJË ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR LUSHNJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me email e datës 17.05.2023, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

- I. Ndryshimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të Vendimit Nr. 145, datë 28.03.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

“1. Gjyqtari i Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Fier, Rudi Laze, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR